



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 757 Prot.

Tiranë, më datë 29.07.2020

**VENDIM**

**Nr. 223, datë 21.07.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.07.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Koncepti i gërmimit arkeologjik në Kalanë e Tepelenës të realizuar nga Luan Përzhita, me aplikues shoqërinë zbatuese “2 T” sh.p.k. në kuadër të zbatimit të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të kalasë së Ali Pashë Tepelenës dhe vazhdimi i shëtitores përgjatë hyrjes së kalasë loti II (segmenti porta perëndimore – busti i Selam Musait);
2. Të sillet plani i punës për realizimin e gërmimit arkeologjik;
3. Të sillet raporti i gërmimit arkeologjik në përfundim të gërmimeve arkeologjike për miratim pranë KKTKM-së;
4. Të sillet projekti i rishikuar në përputhje me rezultatin e gërmimeve nga subjekti zbatues
5. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

**KRYETAR**

Elva MARGARITI

